




DEMOCRACYPLUS



Shënim Politikash

Katër vjet, katër kryeministra nga Agjenda e Reformave Evropiane tek Agjenda e Reformave Evropiane II: Ku qëndrojmë tani?!

Dhjetor 2020



Shënim Politikash

Katër vjet, katër kryeministra nga Agjenda e Reformave Evropiane tek Agjenda e Reformave Evropiane II:
Ku qëndrojmë tani?!

Dhjetor 2020

Përgatitur nga: Dr. Albana Rexha

Dizajn: Envinion

Copyright© 2020. Democracy Plus (D+) dhe Konrad-Adenauer-Stiftung

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet ose të transmetohet në ndonjë formë ose me ndonjë mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjetër, pa lejen e D+.

Ky botim u mbështet nga **Konrad Adenauer Stiftung (KAS)**. Pikëpamjet e shprehura nuk pasqyrojnë detyrimisht pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung.

* Ky shënim politikash është shkruar në gjuhën angleze, andaj për çdo paqartësi në këtë version të përkthyer dhe përshtatur, të lutem konsultohuni me versionin origjinal "Four Years, Four Primeministers, from ERA to ERA II: Where do we Stand?!"

Hyrje

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), e para marrëveshje kontraktuale e Kosovës me BE, shënoi sivjet përvjetorin e pestë. Në mars 2016, qeveria hartoi një Plan Kombëtar për zbatimin e MSA-së (PKZMSA), i cili u miratua nga Kuvendi pas një rishikimi nga Komisioni për Integrimin Evropian¹. PKZMSA përbën një dokument të përgjithshëm të politikave që përfshin masat afatshkurtra për 2016 dhe masat afatmesme për 2017-2020. Këto janë të shpërndara në mes tri blloqeve: standardeve politike, ekonomike dhe legjislacionit të BE (EU Acquis), të shoqëruara me nga një periudhë dhe një institucion përgjegjës për zbatimin e tyre.

Përgjatë këtyre viteve, Qeveria, por edhe shoqëria civile, monitoruan zbatimin e PKZMSA, për të siguruar përgjegjshmëri dhe transparencë brenda nivelit më të lartë politik të administratës, si dhe për ta informuar publikun e gjerë. Raportet e monitorimit, siç shpjegohet në seksionin tjetër, tregojnë se institucionet nuk kanë arritur t'i zbatojnë plotësisht masat e parashikuara në asnjërin prej periudhave njëvjeçare.

Paralelisht, dhe me qëllimin për t'i maksimizuar përfitimet ekonomike dhe politike të MSA-së, Komisioni Evropian (më tutje, Komisioni) filloi një dialog të nivelit të lartë mbi prioritetet kryesore me Kosovën, duke rezultuar në Agjendën e Reformës Evropiane (ERA). Ajo u hartua në bashkëpunim të ngushtë midis Komisionit, autoriteteve të Kosovës, shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit.² Sigurisht, ARE nuk përfshin reforma të reja, por shërben si dokument për t'u dhënë përparësi disa politikave që burojnë nga MSA, në lidhje me legjislacionin dhe masat zbatuese. Plani i veprimit për zbatimin e ARE u miratua në nëntor 2016 nga Qeveria Mustafa.

ARE përfshinte tri shtylla: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, konkurrencën dhe klimën e investimeve, si dhe arsimin dhe punësimin, me 22 masa të shpërndara në tri shtylla, të gjitha të parapara për t'u zbatuar nga institucionet përgjegjëse në fund të vitit 2017.³ Ky dokument i politikave është dizajnuar për të qenë në përputhje me Programin e Reformës Ekonomike të Kosovës, dokumentin kryesor të politikave ekonomike që udhëheq dialogun ekonomik me BE-në. Megjithatë, ky dokument do të duhej të ishte në përputhje me programin qeveritar që rëndom ndryshon varësisht prej partive politike që marrin pushtetin dhe formojnë qeverinë. Me këtë parasysh, ARE duhet të jetë në linjë me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit - dokumentin kryesor të politikës - me qëllim që ta rris nivelin e zbatimit. Qeveria Mustafa u zotua t'i përmbushte këto masa brenda një periudhe njëvjeçare në përputhje me planin e veprimit; megjithatë, këto prioritetet nuk u zbatuan në vitin 2020, deri në kohën e shkrimit të kësaj analize.

Nga ana tjetër, pas ndryshimit të qeverisë në shtator 2017, u adoptua ARE tjetër; qeveria Haradinaj miratoi të ashtuquajturën ARE II.⁴ Ndryshe nga ARE, ky dokument u miratua në mënyrë të njëanshme pa konsultime paraprake me Komisionin. Rrjedhimisht, dokumenti krijoi paqartësi në mesin e administratës publike dhe shoqërisë civile në kontekst të asaj se cili dokument duhet t'u shërbente si kryekorniza udhëzuese. Për më tej, erdhi një tjetër qeveri e re në pushtet më 2020 dhe, megjithëse nuk janë zbatuar të gjitha masat nga ARE ose e ashtuquajtura ARE II, një ARE II e re u miratua në tetor 2020.

1 Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së Ministria e Integritimit Evropian. Në dispozicion në <http://mei-ks.net/sq/programi-kombetar-per-zbatimin-e-msa-se>

2 Republika e Kosovës, Qeveria. "Kosovo- EU High Level Dialogue on Key Priorities – European Reform Agenda". Nëntor 2016, Prishtinë

3 po aty

4 Republika e Kosovës, Vendimi i Qeverisë 01/13. "Prioritetet kryesore të Agjendës Evropiane për 2018". Nëntor 2017, Prishtinë. Në dispozicion në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_13-t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%3ABs_2017.pdf

Zbatimi i ARE qe planifikuar për një vit, por u deshën katër vjet për të kaluar tek ARE II, ndonëse nuk janë zbatuar të gjitha masat nga ARE. Në këtë periudhë katërvjeçare, Qeveria u dre-

jtua nga katër kryeministra të ndryshëm, shoqëruar me dy palë zgjedhje të hershme parlamentare, dhe gjatë kësaj periudhe një vit kishim qeveri në detyrë.




Figura 1: Ndryshimet e Qeverisë në Kosovë nga ARE tek ARE II (2016-2020)

Kjo paqëndrueshmëri politike cenon aftësinë e qeverisë për t'u përqendruar në reforma. Për më tej, faktorë të tjerë si mungesa e vullnetit politik, kostoja e reformave, mungesa e përafrimit me strategjinë kombëtare të zhvillimit, kontribuojnë për të shpjeguar gjendjen aktuale të çështjes drejt zbatimit të prioriteteve të politikave të miratuara në nivelin më të lartë politik në qeveri.

Pra, kjo përmbledhje së pari ndjek zhvillimet e ARE dhe kalimin e saj në ARE II, duke identifikuar faktorët ndërhyrës në suksesin e tyre. Ajo më tej heton ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet dy dokumenteve. Më tutje, shqyrton përafrimin e ARE II me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe përfundon me një reflektim të shkurtë mbi rrugën para.

Shtegu i Agjendës së Reformës Evropiane në Agjendën e Reformës Evropiane II

ARE u miratua në nëntor 2016 nga Qeveria Mustafa në bashkëpunim me Komisionin dhe përfshiu tri shtylla prioritare: (a) qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, (b) konkurrencën dhe klimën e investimeve, (c) arsimin dhe punësimin. 22 masa dhe 131 aktivitete u shpërndanë në të trija shtyllat. Pas një viti, në nëntor 2017, Qeveria e sapozgjedhur Haradinaj miratoi në mënyrë të njëanshme të ashtuquajturën ARE II. Ky dokument politikash përfshinte tri fusha prioritare: (a) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, (b) konkurrenca dhe klima e investimeve, (c) arsimi dhe punësimi. Tri prioritetet e shtyllës së politikave të të ashtuquajturës ARE II ishin identike me ARE, megjithëse përfshinin masa të reja për çdo shtyllë. Pasi u miratua i ashtuquajturi plan veprimi ARE II, u përhap një paqartësi në administratë se cili dokument politikash (ARE ose e ashtuquajtura ARE II) duhej ndjekë. Kjo huti lindi për shkak të mënyrës së njëanshme se si Qeveria zhvilloi të ashtuquajturën ARE II.

Zbatimi i ARE ishte i parregullt që nga fillimi për shkak të faktorëve tashmë të përmendur, duke rezultuar me vonesa të dukshme. Ministria e Integritimit Evropian (aktualisht është në proces tranzicioni në zyrë brenda Zyrës së Kryeministrit), koordinatori i përcaktuar i këtyre reformave, hartoi një raport monitorimi

në dhjetor 2018, që mbulonte një periudhë dyvjeçare (2016-2018).⁵ Sipas tij, vetëm 10 nga 22 prioritetet dhe 92 masa ishin zbatuar plotësisht (45.45% dhe 68.15% respektivisht), ndërsa 12 prioritete dhe 43 masa (54.55% dhe 31.85% respektivisht) ishin në zhvillim.⁶ Sipas të njëjtit burim, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit performuan më së miri, me pesë (5) nga nëntë (9) prioritete të kompletuara plotësisht, pasuar nga arsimit dhe punësimi me tri (3) nga gjashtë (6) të kompletuara plotësisht, si dhe konkurrenca dhe klima e investimeve me dy (2) nga shtatë (7) prioritete të kompletuara plotësisht. Sidoqoftë, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për të pezulluar Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, masë kjo nën shtyllën e parë, numri i prioriteteve në ARE u ul në 21, duke rritur artificialisht përqindjen e gjithëmbarshme të prioriteteve të kompletuara plotësisht në 47.61%.⁷ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nxjerr në dritë procesin e shkujdesur dhe të dobët të ligjvënies, duke deklaruar kështu se ligji është i pazbatueshëm. Aktualisht, gjithë strukturës ligjore të administratës publike i mungon gjysma e themelit. Ky vendim tregon edhe për procesin e dobët të hartimit të ligjit

Në tërësi, numri i përgjithshëm i masave të zbatuara plotësisht nuk e arrinte as gjysmën e planifikuar. Paralelisht me vlerësimin e qeverisë, monitorimi i shoqërisë civile raportoi edhe se 10 nga 22 masa ishin përfunduar plotësisht, 15 ishin në proces dhe katër nuk ishin përfunduar.⁸ Është me rëndësi të theksohet se raporti i monitorimit i qeverisë dhe i shoqërisë civile tregon të njëjtën përqindje të masave që po zbatohen dhe janë në proces miratimi, duke shpalosë besueshmërinë e përmasës së monitorimit të qeverisë.

5 Raporti Përfundimtar mbi zbatimin e Agjendës Evropiane të Reformës (2016-2018). Ministria e Integritimit Evropian, Republika e Kosovës. Dhjetor 2018 Në dispozicion në <https://www.mei-ks.net/sq/agjenda-pr-reforma-evropiane-era>

6 po aty

7 Shih Rishikimin Kushtetues të Ligjit Nr. 06 / L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Numër rasti KO219/19. Në dispozicion në <https://gjk-ks.org/en/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-ligjit-nr-06-l-111-per-pagat-ne-sektorin-publik/>

8 Raporti ARE i Monitorimit të Shoqërisë Civile. Në dispozicion në <http://www.eramonitoring.org/>

Ndërkohë, peisazhi politik u ndryshua prapë përmes zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Haradinaj dha dorëheqjen në korrik 2019 pasi u thirr për pyetje nga Dhomat e Specializuara.⁹ Megjithatë, Haradinaj shërbeu si kryeministër i përkohshëm për gjashtë muaj, deri në shkurt të vitit 2020 kur erdhi në fuqi një qeveri e re e udhëhequr nga Vetëvendosje. Fatkeqësisht, nuk ka ligj për qeverinë që rregullon kompetencat e një qeverie të përkohshme; megjithatë, qeveria e përkohshme automatikisht humb fuqinë për të dërguar legjislacionin për miratim në parlament. Meqë bërja e legjislacionit është forma më e shpeshtë e politikëbërjes në Kosovë, shumica e reformave u vunë në pritje gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore. **Kështu, me këto ndryshime politike, qëndrueshmëria e reformave ka qenë e kufizuar.**

Më 25 mars, anëtarët e parlamentit, mes pandemisë COVID 19, përmbysën qeverinë Kurti me votë mosbesimi, duke e bërë qeverinë më jetëshkurtër në pushtet. Kosova pastaj pati qeveri të përkohshme për dy muaj, deri më 3 qershor kur u zgjodh një qeveri e re e udhëhequr nga LDK-ja, ish-partneri i koalicionit i Vetëvendosjes në qeverinë Kurti. **Ky mjedis i ashpër politik ka shkaktuar padyshim humbje në qëndrueshmërinë e reformës.**

Për më tej, katër muaj pas vendosjes së qeverisë së re, në tetor 2020, Qeveria Hoti miratoi ARE II në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin.¹⁰ Kjo ARE II përfshin tri shtylla prioritare: a) qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, b) konkurrencën, klimën e investimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe c) arsimin, punësimin dhe shëndetësinë. Një plan veprimi mbetet për t'u finalizuar, ndonëse kemi një Draft Plan Veprimi për ARE II të planifikuar për të hyrë në fuqi në janar 2021.¹¹

9 Shih Deklaratën e Dorëheqjes nga Kryeministri Haradinaj, 19 korrik 2019. Në dispozicion në <https://kryeministri-ks.net/deklarata-e-doreheqjes-se-kryeministrit-haradinaj/>

10 Shikoni Vendimin e Qeverisë së Kosovës. Nr. 02/36. 19 tetor 2020 Në dispozicion në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/10/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-36-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

11 Gjatë gjithë dokumentit, i referohemi draft planit aktual si ARE II. Prandaj, krahasimi dhe analiza bazohen në draftin aktual të ARE II të shpërndarë nga qeveria me komunitetin e OShC-ve më 28 tetor 2020.

Prioritetet e politikës së Agjendës së Reformës Evropiane krahasuar me Agjendën e Reformës Evropiane II

Ndryshe nga paraardhësja e saj, ARE II përfshin dy shtylla shtesë thelbësore: zhvillimin e qëndrueshëm dhe shëndetin. E ndërsa liderët botërorë janë pajtuar se e ardhmja duhet të jetë e gjelbër dhe e qëndrueshme, përafrimi i politikave të qeverisë sonë me Agjendën 2030 është hap në drejtimin e duhur dhe duhet duartrokatur. Asambleja unanimisht miratoi edhe Rezolutën OZHQ, duke u bashkuar me komunitetin global në ndërtimin e një të ardhmeje të drejtë dhe të qëndrueshme për fëmijët tanë.¹² Paralelisht, shëndetësia duhet t'i kryesojë përparësitë e qeverisë në vitet e ardhshme, veçmas tani me pandeminë COVID dhe planin e rimëkëmbjes ekonomike. Prandaj, përfshirja e politikës shëndetësore në listën e përparësive të ARE II është vendim i domosdoshëm.

Kur krahason ARE me ARE II për sa u përket prioritetëve të përshkruara të politikave, mund të vërehet përsëritja e disa përparësive që nuk ishin zbatuar gjatë viteve paraprake. Analiza zbulon se masat për krijimin e një historiku të fuqishëm mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përmirësimi i mëtejshëm i procesit të emërimeve dhe shkarkimeve të zyrtarëve të lartë publikë ndërkohë që sigurohet procesi i përzgjedhjes transparente, i bazuar në merita dhe jopolitik, dhe vazhdimi i procesit të racionalizimit të institucioneve dhe agjencive të pavarura pas rishikimit të pavarur, janë ndër masat që kanë nevojë për fokus të vazhdueshëm dhe vullnet politik për zbatim të suksesshëm nën shtyllën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit (Shtylla I). Kostot e larta politike që këto reforma mbartin për qeverinë, janë faktor shpjegues i dobët mbi mungesën e zbatimit të tyre.

Shtylla e dytë mbi konkurrencën, investimet dhe zhvillimin e qëndrueshëm (Shtylla II) përfshin gjithashtu masa që ishin pjesë e ARE, si promovimi i

12 Shih Rezolutën për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Parlamenti, Legjislatura VI. 25/01/2018. Prishtinë. Republika e Kosovës

investimeve të huaja direkte dhe zbatimi sistematik i planit të veprimit kundër ekonomisë joformale. Të dy masat janë të lidhura ngusht me sundimin e ligjit - sektor ky që has në mungesën e vullnetit politik për ta përmirësuar. Çdo kompani e huaj që don të investojë në Kosovë ka nevojë për një sistem efikas të drejtësisë dhe ligje që garantojnë zbatimin e kontratave, ndër të tjera.

Për më tej, në lidhje me punësimin, arsimin dhe shëndetësinë (Shtylla III), ARE parashikoi hartimin e një plani veprimi për ta trajtuar papunësinë e të rinjve, ndërsa në ARE II objektivi është ulja e papunësisë së të rinjve nëpërmjet zbatimit të planit të veprimit për punësimin e të rinjve. Përmirësimi i cilësisë së arsimit vazhdon të jetë objektiv edhe në ARE II.

Për më shumë, një aspekt ndërsektorial në të trija shtyllat është zbutja e ndikimit të COVID-19 në të gjitha prioritetet e politikave. Për shembull, Shtylla I parashikon sigurimin e masave lehtësuese për ndikimin e pandemisë COVID-19 në mbajtjen e seancave gjyqësore në gjykimet penale për rastet e transferuara nga EULEX. Në Shtyllën II, parashikohet zbatimi i masave post-COVID-19 për të mbështetur sektorin privat dhe punonjësit e prekur nga kjo krizë, si dhe sigurimin e një mbulimi të shtuar të përfitimeve sociale në baza nevojë për grupet më të prekura. Shtylla III tregon nevojën për të forcuar aftësinë e Kosovës për të zbuluar, vlerësuar dhe reaguar ndaj ngjarjeve të shëndetit publik, duke marrë parasysh vlerësimin e kapaciteteve të Kosovës në fushën e mbikëqyrjes, parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse.

Përafrimi i Agjendës së Reformës Evropiane II me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZh) (2016-2021), ka fokusin kryesor në rritjen dhe shërben si mjet për avancimin e agjendës së Kosovës për Integrim Evro-

pian (Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, 2016).¹³ Në funksion të kësaj, masat e saj duhet të përputhen me Agjendën e Reformës Evropiane dhe Programin e Reformës Ekonomike, i cili shërben si dokument kryesor në dialogun ekonomik me BE. Për më tej, në bazë të tyre, të tri dokumentet duhet të pasqyrojnë përmbajtjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Harmonizimi i këtyre dokumenteve kryesore të politikave, që përforcojnë njëri-tjetrin, do të eleminonte masat dhe objektivat e mbivendosura dhe do ta përmirësonte koordinimin.

Prandaj është e rëndësishme të analizohet nëse përparësitë e ARE II janë të harmonizuara me SKZh. Kjo e fundit përfshin katër shtylla: a) Kapitalin Njerëzor, b) Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit, c) Industrinë Konkurruese, d) Infrastrukturën. Vlen të përmendet se kjo strategji gjithëpërfshirëse e zhvillimit e lë plotësisht jashtë sektorin e shëndetësisë. Përkundrazi, ARE II përvetëson shëndetin si përparësi shtyllë dhe përfshin pesë (5) masa, përfshirë miratimin e një strategjie të re shëndetësore; rishikimin e bazës ligjore në fushën e sigurimeve shëndetësore; miratimin e një ligji për sëmundjet e infeksionit; zhvillimin dhe miratimin e planit të veprimit për të adresuar rekomandimet e vlerësimit të ECDC për zhvillimin e kapaciteteve; qeverisjen shëndetësore, mbikëqyrjen, gatishmërinë dhe reagimin në fushën e sëmundjeve ngjitëse; vlerësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës, performancën e institucioneve shëndetësore dhe kënaqshmërinë e pacientit. Nga ana tjetër, Ministri i Shëndetësisë ka miratuar një strategji sektoriale për shëndetin që mbulon periudhën 2017 - 2021. Rrjedhimisht, ka një strategji sektoriale për shëndetin, që është pjesë e listës së përparësive ARE II, por nuk reflektohet në strategjinë kombëtare të zhvillimit të qeverisë. Pra, në fushën e politikës shëndetësore ka mungesë të përafrimit midis ARE II dhe NDS.

Një sektor tjetër i ndërlidhur, arsimit, është gjithashtu pjesë e shtyllës së tretë në ARE II, ndërsa në SKZh është adresuar si pjesë e shtyllës së parë mbi kapitalin njerëzor. ARE II përcakton 19 masa në lidhje

13 Shih PLANIN për zhvillim të qëndrueshëm. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016 -2021. Republika e Kosovës. Zyra e Kryeministrit, 2016.

me vlerësimin e nevojave, vlerësimin e jashtëm të performancës parauniversitare, rritjen e kapaciteteve njerëzore, rishikimin e legjislacionit dhe të ngjashme. Ngjashëm, në SKZh trajtohet cilësia e arsimit parauniversitar, hendeku midis sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës, dhe forcimi i procesit të akreditimit dhe inspektimit.

Për më tej, ARE II adreson edhe punësimin në shtyllën e saj të tretë, duke u përqëndruar në nevojën për t'ua rritur numrin dhe për t'ua përmirësuar shërbimet inspektorëve të punës, për t'i forcuar kapacitetet njerëzore të inspektoratit të punës përmes trajnimit në fushën e sigurisë në punë në sektorët e ndërtimit dhe të energjisë dhe për hetimin e aksidenteve në punë dhe nevojën për mbrojtje më efektive të shëndetit të punëtorëve në vendet e tyre të punës. Masa dhe objektiva të ngjashëm adresohen në pjesën e dytë të shtyllës së Kapitalit Njerëzor në SKZh. ARE II dhe SKZh përfshijnë masa të ndryshme në lidhje me arsimin dhe punësimin, megjithatë në përgjithësi i adresojnë sfidat kryesore të sistemit dhe parashikojnë masa të ngjashme zbatimi.

Për më tej, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit janë përfshirë si shtyllë e veçantë, si në ARE II ashtu edhe në SKZh. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit janë përparësia që haset në pothuajse të gjitha dokumentet dhe përparësitë e politikave qeveritare. Megjithatë, ka mungesë të vullnetit politik për t'i kthyer këto masa të planifikuara në rezultate të prekshme. Një faktor që shpjegon gjendjen në qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit mund të jetë kostoja e lartë politike që mbartin këto reforma. Për më shumë, ky sektor ka mbuluar vazhdimisht edhe pjesën më të madhe të hapësirës së debatit publik. Masat e SKZh-së kanë të bëjnë me forcimin e sistemit të drejtave pronësore në mënyrë që të krijojnë siguri juridike midis investitorëve; të shtojnë efikasitetin e gjyqësorit - në veçanti për ta shkurtuar kohën për zgjidhjen e çështjeve; përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për biznesin dhe publikun; të përmirësojnë sistemin e prokurimit publik për ta ulur korrupsionin; të përmirësojnë efikasitetin dhe koordinimin e inspektimeve shtetërore; rregullt të shyrqtojnë politikat rregullatore për t'u siguruar që biznesi nuk sanksionohet për shkak të një ligji/rregulloreje që ndalon punën e ligjshme; dhe ka-

limin nga taksimi kufitar në tatim brenda Kosovës duke bashkuar Administratën Tatimore dhe Doganat në menaxhim më efektiv dhe dekrete të kostove të funksionimit dhe nivelit të informalitetit. ARE II përfshin masa të lidhura me zbatimin e legjislacionit anti-korrupsion, zbatimin e gjyqësorit dhe punët e brendshme; përmirësimin e kornizës së politikës së imigracionit, luftën kundër terrorizmit dhe zbatimin e strategjisë për sundimin e ligjit. Masat e ARE II janë më specifike dhe lidhen me politikën anti-korrupsion, ndërsa SKZh shkon më tej duke përfshirë masa në lidhje me taksat dhe politikat rregullatore me qëllim krijimin e një konkurrence të ndershme në treg.

Thënë kjo, aftësia konkurruese, investimet dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë shtylla e dytë e ARE II, që lidhet ngusht me masat e SKZh-së për Investimet dhe njërin nga objektivat e strategjisë drejt vendosjes së konkurrencës së ndershme. Sidoqoftë, zhvillimi i qëndrueshëm është injoruar plotësisht dhe nuk përmendet as në seksionin ku diskutohet përafrimi dhe përkimi i SKZh-së me dokumente të tjera të politikave si MSA dhe PRE. Me rëndësi që të theksohet është se përafrimi i zhvillimit të qëndrueshëm me dokumentet e tjera mbetet zhvillim i ri.

Diskutimi dhe rruga përpara

Qeveria e Kosovës, në konsultim me Komisionin, zhvilloi dhe miratoi planin e veprimit ARE në 2016. ARE përfshiu 22 masa të shpërndara në tri shtyllat. Vetëm gjysma e masave të ARE u zbatuan me sukses, megjithëse ky dokument u miratua në nivelin më të lartë politik, ku u proklamua angazhim i fortë politik për reformën. Ndërkohë, janë zhvilluar dy zgjedhje të parakohshme parlamentare (2017 dhe 2019), pasuar me ndryshime në zyrën e kryeministrit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se gjatë kësaj periudhe qeveria drejtohej nga dy kryeministra të përkohshëm për një vit. Gjatë gjithë kësaj kohe, reformat ose përparuan me ritëm të ngadaltë ose u vunë në pritje, duke çuar në vonesa në zbatimin dhe avancimin e përgjithshëm të agjendës së BE.

Numri i masave të pazbatuara në ARE paraqet pamje shqetësuese të gjendjes dhe tregon se ARE ka humbur rëndësinë kur është përfshirë në kontekstin politik kaotik të brendshëm.

Katër vjet më vonë, më 2020, Kosova u drejtua nga kryeministri Kurti për 50 ditë, dhe nga i njëjti si ushtrues detyre për 50 ditë të tjera. Që nga 3 qershori Kosova drejtohet nga kryeministri Hoti i LDK-së. Qeveria e tij në konsultim me Komisionin miratoi prioritetet e ARE II, në tetor. Tani është zhvilluar një draft plan veprimi për zbatimin e këtyre prioritetëve që bazohet në 133 aktivitete. Siç pasqyron analiza, disa masa në ARE II ishin gjithashtu pjesë e ARE. Reformat e përsëritura në shtyllën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit kanë të bëjnë me kosto të larta politike. Masat e ARE si sigurimi i një historiku mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar, depolitizimi i zyrtarëve të lartë publikë duke siguruar procesin e përzgjedhjes transparente, të bazuar në merita dhe jopolitike, dhe racionalizimi i agjencive të pavarura janë masa edhe të ARE II; megjithatë, kostoja politike për t'i zbatuar me sukses këto reforma mbetet e lartë. Duke pasur parasysh këtë, hezitimi për t'i zbatuar ato pritet të jetë po ashtu i lartë, si në vitet e mëparshme. Ky ngurrim, i kombinuar me paqëndrueshmërinë politike të shkaktuar nga ndryshimet e shpeshta të qeverisë, na ofron një skenar zbatimi në shkallë të ulët.

Prandaj, ka nevojë për monitorim të vazhdueshëm dhe presion nga poshtë-lart (shoqëria civile, përfshirë mediat, veçanërisht gazetaria hulumtuese) e kombinuar me presionin nga lart-poshtë (nga BE), të ashtuquajturin "presion sanduiç" ndaj qeverisë. Ndërkohë, për ta rritur nivelin e zbatimit dhe për t'i eliminuar objektivat e mbivendosur, masat ARE II duhet të harmonizohen me ato të SKZh.

Më e rëndësishmja, stabiliteti politik mbetet kushti themelor drejt qëndrueshmërisë së reformës; prandaj, udhëheqësit e partive duhet të tregojnë pjekuri politike dhe të synojnë të ndërtojnë konsensus ndërsa i japin përparësi agjendës së integritetit evropian në praktikë. Fokusi duhet të vihet në sektorin shëndetësor dhe rimëkëmbjen ekonomike nga pandemia e COVID-19. Si përfundim, duhet të nxirren mësim nga pamundësia e zbatimit të suksesshëm të masave të ARE për të shmangur përsëritjen e gabimeve të mëparshme.



Democracy Plus (D+) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse dhe jopartiake, e regjistruar zyrtarisht në mars 2016. D+ përpjet për zhvillimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes qytetare në procesin politik, duke gjeneruar përgjegjësi më të madhe publike dhe duke ndikuar në vendimmarrje. Ne integrojmë teknologjinë e informacionit në të gjitha përpjekjet tona, ndërsa bëjmë përpjekje për të shfrytëzuar fuqinë e internetit, i cili luan rol të rëndësishëm për demokratizimin e shoqërisë.

D+ synon të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira të qeverisjes në institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal, forcimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike dhe procesin e zgjedhjeve të lira e të ndershme.